



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSH TRRISË - OPŠTINA VUÇITRA

01 Nr. / Br 326/22

Nr. i fq. / Br. st -3-

Data: / Datum 29.12.2022

11/02/2015 - 11/02/2015



**REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - VUSHTRRI**

**RREGULLORE
(KKV) NR.03/2022 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E
RREGULLORES PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN
E VUSHTRRISË**

Dhjetor, 2022

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja "c" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 15 pika 1.8 dhe 34 të Ligjit për Mbeturina Nr. 04/L-60, nenin 8 shkronja a) të Ligjit nr. 03/L-49 për Financat e Pushtetit Lokal, nenin 19 paragrafi 1 pika 1.3 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datën **29 dhjetor 2022** miraton këtë:

RREGULLORE
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR MENAXHIMIN E
MBETURINAVE NË KOMUNËN E VUSHTRISË

Neni 1

Me këtë Rregullore ndryshohet dhe plotësohet Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë Nr.05/2020, protokollit Nr. 115/20, datë 25.06.2020.

Neni 2

Në nenin 7, paragrafi 5 riformulohet si vijon:

„Ekonomitë familjare të cilat ngarkohen me tarifë të energjisë elektrike në shumën totale prej pesëmbëdhjetë (15.00 €) të njëjtat obligohen për të paguar tarifën vjetore të mbeturinave në vlerën tetëmbëdhjetë euro në vit (18.00 €). Ky paragraf vlen vetëm për qytetarët jo rezident të Komunës së Vushtrrisë.

Neni 3

Shtojca e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë Nr.05/2020, prot. nr. 115/20, datë 25.06.2020, riformulohet si vijon:

1. Tarifa për amvisëritë, konsumatorët e rregullt (kategoria A):
 - 1.1.Zona Urbanenga 4.4 € në muaj në 6.00 € në muaj
 - 1.2.Zona Ruralenga 4.4 € në muaj në 6.00 € në muaj
2. Tarifa për amvisëritë nga Diaspora (D):
 - 2.1.Zona Urbanenga 13.20 € në vit në 18.00 € në vit
 - 2.2.Zona Rurale nga 13.20 € në vit në 18.00 € në vit
3. Tarifa për biznese dhe lokale tjera afariste:
 - 3.1. Lokalet e bizneseve me hapësirë prej 01-20 m2nga 5.30 € në 7.00 € në muaj
 - 3.2.Lokalet e bizneseve me hapësirë prej 21-50 m2 ..nga 11.70€ në 15.00 € në muaj
 - 3.3.Lokalet e bizneseve me hapësirë mbi 50 m2nga 23.50 € në 25.00 € në muaj
4. Tarifa minimale për institucionet publike dhe bizneset e shkallës më të lartë bëhen me kontraktim individual me kontraktuesin e shërbimit.
 - 4.1. Kostoja e kontejnerit 1.1 m3nga 11.50 € 14.00 € për zbrazje
 - 4.2. Kostoja e kontejnerit 7.0 m3nga 50.68 € në 60.00 € për zbrazje

Neni 4

Për zbatimin e kësaj rregullore obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtorja për Shërbime Publike dhe Drejtorja për Buxhet dhe Financa

Neni 5

Kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë dhe do të zbatohet nga data 01 janar 2023.

Melihate Basholli-Latifi



Kryesuese e Kuvendit